



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 31.03.2017,  
e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Flamur Shala (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Shefqet Sylejmani (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Berat Lahu (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shaip Shabani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo (KDTP).

**Munguan:** Vlora Dumoshi (LDK), Blerand Stavileci (PDK), Ylli Hoxha (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Remzi Pacolli (AKR) dhe Abit Kastrati.

**Të pranishëm** ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

**Kryesuesi e ftoi z. Shefqet Sylejmani, anëtarë i LDK-së, që ta bëjë betimin para anëtarëve të Kuvendit.**

**Kryesuesi e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.**

**Agim Gashi**, lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, tha se kjo duhet të riformulohet. Edhe në KPF kemi dhënë vërejtje për këtë. Do të ishte më e drejtë të thuhet: “Propozimvendimi për caktimin e lokacioneve për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe”, pastaj mund të thuhet: “sipas planit për vendosjen e tyre”.

**Qëndron Kastrati** kërkoi që pika e gjashtë e rendit të ditës, të shkojë si pikë e fundit ose para pikës “Pyetje dhe përgjigje”.

**Lirak Çelaj** u shpreh se në mbledhjen e fundit të KPF-së u pajtuam që të futet në rend të ditës edhe çështja e vazhdimit të kontratës, ose së paku të diskutojmë për Qendrën për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës, andaj propozoj që kjo pikë të futet në rend të ditës.

**Imer Rusinovci** paraqiti një kërkesë në emër të shkollës “Don Bosko”, për zgjerim të kapaciteteve të saj, sepse është një numër i konsiderueshëm i nxënësve që vijojnë mësimin në atë shkollë. Mendoj se kemi obligim si asamblistë që t’i përgjigjemi kërkesës së tyre, së paku në mbledhjen e radhës.

**Kryetari, Shpend Ahmeti** dha sqarime për këtë. Ai tha se për këtë çështje është diskutuar shumë. Inspektorati e ka verifikuar që nuk është projekti i njëjtë edhe lokacioni ka ndryshuar. Janë udhëzuar që të pajisen me leje të re, sepse ky është projekt i ri dhe ndërtesa është krejtësisht e re. Pra “Don Bosko” i ka pasur dy zgjidhje, ose ta bëjë ndërtesën sipas lejes që e kanë marrë në vitin 2001, ose duhet pritur ndryshimin e Planit rregullues “Kalabria” për të mundur me e ndryshuar.

**Ardian Olluri** sqaroi se lokacioni caktohet me planin, që është pika e dytë, d.m.th. lokacioni për vendosjen e qoshqeve është plani që përcakton lokacionet se ku kanë me u vendosur qoshqet, ndërsa ky është vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim, sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ që e përcakton se propozimin e Kryetarit për dhënien në shfrytëzim duhet miratuar Kuvendi me vendim paraprak.

**Kryesuesi** konstatoi se dy propozimet do t’i qesim në votim, i pari si është i formuluar: “Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, në lokacionin sipas planit për vendosjen e tyre”, i dyti është propozimi i dhënë nga z. Gashi.

**Kryesuesi** propozoi që të votohet, në mënyrë që të jetë pika e tretë kështu siç është e formuluar në rendin e ditës. Nëse shumica janë për, kalon, nëse jo, atëherë e qesim edhe propozimin e z. Gashi.

Kryesuesi konstatoi se 15 (pesëmbëdhjetë) vota janë për të mbetur kështu siç është e formuluar në rend të ditës, ndërsa 21 (njëzet e një) vota janë kundër dhe 2 (dy) abstenime. Andaj, si pikë e rendit të ditës mbetet propozimi i z. Gashi: *“Propozimvendimi për caktimin e lokacioneve për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, sipas planit për vendosjen e tyre”*.

**Qëndron Kastrati** propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës: “Caktimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Hortikultura” SHA, NPK “Trafik Urban” SHA Prishtinë dhe në KRM “Pastrimi”, të caktohet para pikës: “Pyetje dhe përgjigje”.

Kryesuesi konstatoi se më 19 (nëntëmbëdhjetë) vota për, 17 (shtatëmbëdhjetë) vota kundër, u miratua propozimi që pika e gjashtë “Caktimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL “Hortikultura” SHA, NPK “Trafik Urban” SHA Prishtinë dhe në KRM “Pastrimi”, vendoset para pikës “Pyetje dhe përgjigje”.

**Lirak Çelajt** propozoi që si pikë e rendit të ditës të futet për diskutim Qendra për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës.

**Agim Gashi** paraqiti një kërkesë për ekzekutivin, të drejtuar nga organizata që merret me “Kopshtin e arinjve” në komunën e Prishtinës, duke thënë se në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar që ajo të futet në rend të ditës për mbledhjen e ardhshme. Meqenëse është fjala për një donacion që duhet të investohet në atë projekt dhe që do të jetë shumë i rëndësishëm për interesat e komunës së Prishtinës.

**Kryesuesi** theksoi se me ekzekutivin do ta shikojmë mundësinë për mbledhjen e ardhshme, sepse nuk kemi ndonjë material, kështu që nuk po e qesim në votim propozimin.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e z. Çelaj, që të futet në rend të ditës diskutimi lidhur me Qendrën për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës.

Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 6 (gjashtë) kundër, (Cuneyd Ustaibo, Feti Mehdiu, Hatixhe Latifi - Pupovci, Kimet Zeqa, Muhamet Nura, Vjollca Dibra - Ibrahimimi), dhe 8 (tetë) abstenime (Mirlina Sopi, Nenad Miladinoviqi, Sami Boroci, Shefqet Sylejmani, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva, Visar Arifaj, Flamur Shala), futet në rend dite për diskutim Qendra për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës.

Kryesuesi konstatoi se më 32 (tridhjetë e dy) vota për, 1 (një) votë kundër, (Muhamet Nura) 6 (gjashtë) abstenime, (Genc Sherifi, Mirlinda Sopi, Sami Boroci, Sofije Bunjaku, Sylejman Pireva dhe Laura Zherka), u miratua ky

## R E N D I D I T Ë S :

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së shtatë, të tetë dhe të nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës (2016);
2. Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve në komunën e Prishtinës;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacioneve për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqe, sipas planit për vendosjen e tyre;
4. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015;
5. Shqyrtimi i raportit vjetor buxhetor për vitin 2016;
6. Propozimvendimi për miratimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
8. Diskutim për Qendrën rehabilituese të nënës dhe fëmijës;
9. Caktimi i një anëtarë në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA, NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë dhe në KRM "Pastrimi";
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

### Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së shtatë, të tetë dhe të nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës (2016).

Kryesuesi konstatoi se më 34 (tridhjetë e katër ) vota për, 1 (një) kundër, (Muhamet Nura), 2 (dy) abstenime, (Shefqet Sylejmani dhe Lirak Çelaj), u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së shtatë, të tetë dhe të nëntë të Kuvendit.

### Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve në komunën e Prishtinës.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, fjalën e mori përfaqësuesi i urbanizmit, z. Florim Krasniqi, diskutimet e të cilit janë dhënë të plota në transkript.

**Muhamet Selmani** kërkoi të dijë se lokacionet që janë për këto qoshqet a i përfshijnë qoshqet ekzistuese, apo janë qoshqet të reja që do të vendosen në qytet. Në mbledhjen e kaluar ne e kemi pasur një problem për arsye të afatit, apo skadimit të kontratës që e kemi pas me qoshqet ekzistuese. Kërkoj të dijë se a janë përfshirë këto në këtë pikë, apo janë të ndara.

**Visar Arifaj** kërkoi të dijë se çfarë qoshqe janë ato, çfarë dizajni kanë dhe si planifikohet të duken ato sipas këtij plani.

**Agim Gashi** theksoi se më herët ka ekzistuar dhe është në fuqi një rregullore, mbi bazat e së cilës është dizajnuar dhe është rregulluar çështja e funksionimit të qoshqeve në komunën e Prishtinës. Nuk mund të shkelim mbi një dokument, i cili është valid dhe e ka miratuar ky kuvend, ku në rregullore është saktë e definuar se sa m<sup>2</sup> ka një qoshk. Tash ne e kemi përpara propozimin për 12 m<sup>2</sup> dhe 18 m<sup>2</sup>. Me intereson ta dijë se 18 m<sup>2</sup> a mund të konsiderohet si qoshk në aspektin ligjor, apo lokal afarist, sepse lokali afarist kërkon standarde plotësuese. Këtu janë disa dilema, për të cilat është mirë të na jepni sqarime.

**Mirlinda Sopi** kërkoi sqarim se si do të duken ato qoshqe dhe me çfarë materiali do të punohen, sepse dihet që njëri prej problemeve është se qoshqet ekzistuese kanë pasur një pjesë të madhe nga xhami, që e keni identifikuar edhe ju në material, dhe për koston e mirëmbajtjes së këtyre qoshqeve.

**Sylejman Pireva** kërkoi të dijë se cila është ndërmarrja që i ka punuar qoshqet, cili ka qenë çmimi për qoshk dhe çka do të ndodhë me qoshqet e vjetra që janë zhvendosur.

**Shefki Gashi** shprehu habi, duke thënë se nuk e di cili arkitekt e quan qoshk një objekt prej 18 m<sup>2</sup>. Ai duhet të ketë nyja sanitare, pak tarracë, pak hyrjen, duhet me e zgjatur edhe njëfarë çadre përpara, që do të thotë se me këto qoshqe diku po i humbim rreth 5 ha gjelbërim në komunën e Prishtinës, andaj jam kundër vendosjes së qoshqeve.

**Florim Krasniqi**, lidhur me lokacionet ekzistuese, tha se zyrtarët e planifikimit përveç që i kanë caktuar disa lokacione të reja, e kanë pasur për detyrë që ta bëjnë evidentimin e atyre qoshqeve që nuk janë funksionale. Pra, ato që janë funksionale i kemi lënë, vetëm do të ndërrohet dizajni i tyre.

Sa i përket dukjes, me këtë është duke u marrë Zyra për regjenerim urban, në kuadër të Komunës së Prishtinës, ne jemi marrë vetëm me caktim të lokacionit.

Sa i përket koston dhe cila kompani do ta bëjë punimin e tyre, ende nuk kemi mbërri në atë fazë.

**Ardian Olluri**, shefi i Zyrës ligjore, tha se më 21 dhjetor 2016, është ndryshuar rregullorja që e përmendi z. Gashi. Kuvendi ka marrë një vendim për ndryshimin e rregullores, ku janë lejuar edhe qoshqet me sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se dizajni i qoshqeve është i ngjashëm me atë të Vjenës, Lubjanës dhe Zagrebit, janë qoshqe klasike. E rëndësishme është të merret vendimi për dhënie, pastaj edhe për procedura diskutojmë. Sa i përket koston së ndërtimit, mendojmë se këtë do duhej ta bartë personi që e merr qoshkun në shfrytëzim dhe të jetë pjesë e kalkulimit të ofertës. Për këtë vendos komisioni, se nuk ka nevojë Komuna me ndërtuar, për shkak se po flasim për

dhënien e sipërfaqes, ndërsa nuk kanë kosto të madhe të ndërtimit, por do të duhej të bartej nga ata që duan t'i shfrytëzojnë.

**Lirak Çelaj** shprehu mendimin se do të duhej të kishte një shpallje publike, mos të kopjohet, mund të jetë identike, mund të fitojë ai dizajnë, por për të mirë të qytetit do të duhej dhënë mundësia, sepse mund të ketë dikush ndonjë ide kreative për këtë, që dikush pastaj të mund ta marrë prej neve idenë, prej Prishtinës, pra t'ua japim mundësinë njerëzve. Gjithashtu, më intereson veprimtaria, d.m.th. mënyra, cili do të jetë kriteri, kur do të jepen ato, a do të jetë e imponuar veprimtaria, sepse ato që i kam parë në përgjithësi shesin gazeta dhe e kanë njëfarë standardi se çka shitet në to, po ka qoshqe edhe ku shesin ushqim e të tjera. Pra, a është përcaktuar ky kriter, apo do të përcaktohet.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, tha se sa i përket të parës nuk është ndonjë problem, mendoj që mund të bëhet. E dyta, mendoj që ne si ekzekutiv jemi që të përcaktohen kriteret, jo me u shitur çka të dojë ai që e merr në shfrytëzim, por të përcaktohen gjërat të cilat mund të shiten, që janë klasike për qoshqet, e që janë gazetatat dhe ushqimet e vogla.

**Muhamet Selmani** propozoi që para se të bëhet ankandi publik, ofertimi për këto qoshqe, të bëhet një plan se çka do të lejohet në secilën prej tyre, apo në grupe të caktuara, se çfarë veprimtarie mund të zhvillojnë dhe ai plan të miratohet në Kuvend.

**Flamur Shala** kërkoi sqarim se çka do të bëhet me qoshqet që janë tash në qytet dhe si do të veprohet me ata njerëz të cilët janë të punësuar aty dhe mbajnë familjet e tyre me atë punë. E dyta, si do të veprohet me qoshqet ekzistuese, sepse edhe ato kanë pasur një kosto të caktuar. A do të merret Komuna drejtpërdrejt me to, a do t'i qet në ankand publik për shitjen e tyre ose për heqjen e tyre. Pra, këto janë pyetje që duhet të shtrohen dhe duhet dhënë përgjigje.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se kontratat për shfrytëzim kanë qenë 10-vjeçare dhe ato kontrata kanë përfunduar. Në aspektin ligjor dhënia në shfrytëzim nuk lejon favorizimin e dikujt vetëm pse ka qenë shfrytëzues i një kontrate të kaluar.

**Hatixhe Latifi - Pupovci** lidhur me ndërtimin e qoshqeve, pyeti se a do të jenë ndërtim me tulla, apo konstruksion.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se në ditët e sotme qoshqet janë konstruksion, që duhet pasur edhe dizajnin kreativ, që kur të mbyllen, palosen dhe duken si kuti. Pra, nuk kemi të bëjmë me ndërtim me tulla, janë të montueshme dhe të çmontueshme në periudhë shumë të shkurtër.

**Ajnishahe Azemi** tha se a ka mundësi që kur të bëhen kontratat, të shënohet se nuk kanë të drejtë me vendosur jashtë qoshkut asgjë, në mënyrë që mos të vendosin ata çfarë t'u leverdis atyre, në mënyrë që të ruhet konstruksioni dhe pamja e qoshkut.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, tha se nuk kanë të drejtë ta marrin një qoshk e pastaj të zgjerohen deri në 20 m<sup>2</sup> jashtë qoshkut, për atë arsye edhe po shkojmë në 18 m<sup>2</sup>.

**Kryesuesi** konstatoj se më 30 ( tridhjetë) vota për, 8 (tetë) vota kundër, ( Besa Rafuna, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli ) dhe 2 (dy) abstenime, (Lirak Çelaj dhe Naime Osmani ), u miratua Vendimi për miratimin e planit për vendosjen e qoshqeve në komunën e Prishtinës.

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër për qoshqet, me lokacione sipas planit për vendosjen e tyre.**

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se në qoftë se ka miratim për këtë në aspektin politik, atëherë ia lejojmë Zyrës ligjore që ta bëjë çështjen e emërimit ligjor, në bashkëpunim me Ministrinë, në qoftë se ka nevojë, por veç mos të ketë kundërshtime politike, me thënë përmes kësaj jemi kundër. Në qoftë se është dakordimi, po dihet që po votohet për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave.

**Agim Gashi** tha se Zyra ligjore po thotë se plani e përcakton lokacionin, asnjëherë në këtë Kuvend nuk kemi thënë ndryshe, veç kemi thënë caktimi i lokacionit.

**Qëndron Kastrati** tha se Zyra ligjore e shpjegoi në KPF se Ministria e ka refuzuar një pikë kur e kemi emërtuar me caktim të lokacionit dhe ka thënë tash e tutje duhet të jetë e përpiluar si dhënie e pronës në shfrytëzim.

**Ardian Olluri** ceku se në këtë rast nuk kemi caktim të lokacionit, as planifikim, kemi dhënie në shfrytëzim, d.m.th. është vendim paraprak i Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim. Pra, kryetari propozon miratimin e vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim dhe Kuvendi e miraton.

**Agim Salihu** bëri të ditur se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të paluajtshme, kështu që kjo pikë duhet të emërtohet: “Propozimvendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër”.

**Feti Mehdiu** tha se për këtë pikë u dhanë shumë sqarime, andaj dëshiroj të theksoj se interpretimi që ka ardhur prej Ministrisë, që duhet të jetë dhënia e pronës, jo caktimi i pronës, ka dallim, mund t’ia caktosh, por mos t’ia japësh pronën.

**Kryesuesi konstaton se më 27 (njëzet e shtatë) vota për, 8 (tetë) vota kundër, (Besa Rafuna, Halim Halimi, Laura Zherka, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Muhamet Selmani, Shefki Gashi, Shemsi Veseli) dhe 2 (dy) abstenime (Lirak Çelaj dhe Naime Osmani), konstaton se u miratua vendimi paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.**

#### **Pika e katërt**

#### **Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015.**

**Agim Gashi** tha se auditori i brendshëm nuk e ka kryer punën ashtu siç është e përcaktuar me ligj. Ekzistojnë dobësi të mëdha në disa sisteme të rëndësishme financiare, duke përfshirë të hyrat, prokurimin, shpenzimet pa prokurim, pagat dhe subvencionet. Kjo vonesë për shqyrtimin e raportit të auditimit në Kuvendin e Komunës, ka të bëjë edhe me bashkëpunimin në mes të Kryetarit dhe Kuvendit. Do të ishte mirë që të tejkalohen këto raporte të dallueshme dhe të rritet niveli i bashkëpunimit.

**Shemsi Veseli** bëri vërejtje në emër të GP-së lidhur me raportin, i cili është dashur që të debatohet shumë më herët, e jo të debatohet në muajin e tretë të vitit 2017, sepse raportet që nuk përpunohen me disa të dhëna brenda, me Auditorin e Përgjithshëm,, të jep me kuptuar që ka funksionuar dobët ose nuk kanë qenë aktiv, ose nuk e ka plotësuar planin e përgjithshëm vjetor, ka mangësi të përpilimit të shpalosjeve të pasqyrave vjetore financiare.

Ne si GP kemi shumë pyetje, e në mesin e tyre është pyetja për vlerën e pasurive, që nuk është regjistruar, deri ku ka arritur ky regjistrim. Cilat janë projektet që konstatohen, për të cilat janë paguar këto mjete, cila është rëndësia e tyre dhe si është bërë përzgjedhja dhe financimi i tyre? Nga buxheti për investime kapitale, cili është projekti ku janë investuar këto mjete nga mallra dhe shërbime që janë marrë paratë, si dhe vendimi për bartjen e mjeteve nga investimet kapitale? Ka edhe shumë çështje të tjera që do të duhej theksuar.

**Mirlinda Sopi** shprehu pakënaqësi që ky dokument i punës së vitit 2015, analizohet në vitin 2017. E kemi analizuar dhe i kemi parë qartë ato që janë shkruar nga auditori, gjithsesi mendojmë që e kemi pa si dokument në kontekst pozitiv, me qëllimin më të mirë për përmirësimin e performancës së punës së Komunës. Gjithsesi, ne kërkojmë nga kryetari që të rritë bashkëpunimin me Auditorin, dhe t'i marrë parasysh rekomandimet e Auditorit qoftë për llogaridhënien, qoftë për kontrollin e brendshëm të sistemit financiar, parregullsitë që i kanë gjetur në punësimin në arsim etj. Edhe parregullsitë në subvencione, që shfrytëzoj rastin që edhe ne si GP në shqyrtim të kësaj pike të kërkojmë nga kryetari që brenda këtij mandati, nëse ka mundësi, të përpilojë ndonjë dokument ose ndonjë rregullore që i specifikon qartë kriteret, dokumentet dhe parimet në të cilat duhet të bazohet për dhënien e subvencioneve.

**Rita Begolli**, sa i përket raportit të auditimit, zbatimi i rekomandimeve dhe gjetjeve të auditimit, është një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive. Besoj që këto rekomandime dhe të gjetura në fusha të caktuara, do të nxisin përmirësime pozitive.



**Feti Mehdiu** tha se do të ndalem në dy çështje. Sa i përket raportit të auditimit, ku në një vend thotë: “Shpenzime që nuk kanë mbulesë”, është puna për njëfarë investimi të një orkestre, na erdhi çudi, shpenzime telefoni. Nëse shkon diku ndonjë trup artistike, unë mendoj për telefon ndoshta nuk ka nevojë me ia paguar, që t’i shfrytëzoj mjetet e Komunës edhe për gjëra të tilla, ashtu mendojmë aty. Gjithashtu, ka edhe një tjetër vend këtu te tatimet, ku është lëshuar vendimi, është paguar tatimi, kur shkon atje nuk i gjen paratë aty.

**Abetare Fazliu** tha se duhet të analizohet edhe njëherë raporti dhe të vazhdojë tutje.

**Visar Arifaj**, sa i përket këtij raporti dhe kur është diskutuar edhe në mungesë të planit të veprimit të mëtutjeshëm, tha se mua po më duket që ky është problemi më i madh që po e shoh, pra mos komunikimin dhe në njëfarë mënyre ikjen dhe injorimin e problemeve të komunikimit që e kemi.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, tha se raportet e auditorëve japin dy vlerësime kryesore, ose është raport i pamodifikuar ose i pakualifikuar, ose është raport i kualifikuar. Raporti i pamodifikuar jepet në rastet kur problemet nuk janë të natyrës që shkaktojnë dallime në materialitet. Komunitat të cilat i kanë të regjistruara pronat, por nuk i kanë të regjistruara në thesar, do të vlerësohen pozitivisht, sepse punën e vet e kanë kryer, përderisa Ministria e Financave dhe Thesari kanë mbetur prapa me regjistrim. Por, mund t’u them që Komuna e Prishtinës ka arritur që një pjesë të madhe të pronave tashmë t’i regjistroj edhe në thesar si pasuri të paluajtshme, në mënyrë që mos të paraqitet ky dallim në pasqyrat financiare vjetore prej 2.5 miliardë euro.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah raporti i Auditorit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.**

**Pika e pestë**

**Shqyrtimi i raportit vjetor buxhetor për vitin 2016.**

**Flamur Shala** tha se GP i LDK-së e ka analizuar këtë raport vjetor buxhetor dhe konsideron që në fillim se nuk është i plotë, sepse nëse e shohim pasqyrën e buxhetit dhe realizimin e tij, sidomos në zbatimin e projekteve kapitale, nuk ka dokumente shtesë që do të na e sqaronin secilin pozicion buxhetor lidhur me shpenzimet.

Sa u përket të hyrave vetanake, e shohim një ngritje të këtyre të hyrave krahasuar me vitin paraprak dhe ajo ngritje në disa pozicione buxhetore, siç janë lejet e ndërtimit, krahasuar me vitin 2015 është ngritje shumë e madhe.

Në pjesën për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, sipërfaqet gjelbëruese dhe shpimi i puseve, të planifikuara 700 mijë €, të shpenzuara 700 mijë€, këtu nuk e kemi të qartë sa puse janë të shpuara dhe sa sipërfaqe janë të gjelbëruara.

Te Drejtoria e Kulturës, përkundër planifikimit, as në këtë vit nuk u ndërtua salla koncertale, nuk ka pasur furnizim me libra dhe nuk ka pasur renovim të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Te Drejtoria e Planifikimi Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, për planet rregulluese të hollësishme të parapara 250 mijë €, janë shpenzuar 43 mijë €, ku e dimë që asnjë plan rregullues nuk ka kaluar.

Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë, të planifikuara 500 mijë €, të shpenzuara 1977 €, çka ka ndodhur, janë bartur këto mjete, kanë shkuar diku, apo pse ky shpenzim kaq i vogël, kur e dimë që premtimet për ndihmesë të bujqësisë kanë qenë shumë të mëdha.

Ndërtimi i shkollës në lagjen "Mati 1" 750 mijë € të planifikuara, 55 mijë euro të shpenzuara, ku janë shpenzuar këto 55 mijë €?!

Rrethrotullimi "Lakërishtë " 1 milion të parapara, 998 mijë të shpenzuara, çka ka ndodhur këtu?

Rruga mbi lumin Mat 500 mijë € të planifikuara, 494 mijë € të shpenzuara, dhe për lumin "Mat" më duket se ka qenë një tender dhe është anuluar, është në fazën e ritenderimit dhe asnjë shpenzim nuk është bërë etj.

Në përgjithësi, ky buxhet është buxhet i dështuar në kuptimin e realizimit të projekteve sipas planifikimit.

**Muhamet Selmani** tha se Komuna në tri vitet e fundit vetëm në investimet kapitale ka humbur rreth 49.38 milionë euro, kësaj shume duhet t'i zbresim edhe dy projektet e bartura 17.2 milionëshin e vitit 2013 në vitin 2014, edhe atë 7.2 milionëshin e vitit 2015 në vitin 2016.

Kur flasim për leje të ndërtimit në vitin 2014, nga plani i buxhetit kanë qenë të arkëtuara 13.2 milionë euro, janë inkasuar vetëm 7.32 milionë euro, në vitin 2015 plani ka qenë për 9.5 milionë euro, janë inkasuar 6.54 milionë euro, në vitin 2016 plani ka qenë 8.5 milionë euro, janë inkasuar 10.54 milionë euro dhe, skandaloze, në vitin 2017 edhe pse kemi trend të rritjes, ne i planifikojmë vetëm 7 milionë euro. Nuk e di se sa do të realizohen tani në fund të vitit 2017!

Te tatimi në pronën e pa luajtshme, në vitin 2014 ne i kemi planifikuar 4.6 milionë euro, i kemi realizuar 5.65 milionë euro, në vitin 2015 kemi planifikuar 6.3 milionë euro, kemi realizuar 5.62 milionë euro, në vitin 2016 prapë kemi pasur planin 6.3 milionë euro, kemi realizuar 7.18 milionë euro, skandaloze, në vitin 2017 ne kthehemi edhe për plan i bëjmë vetëm 5.287 milionë euro. Jam i bindur që këto tri vite numri i ndërtimeve dhe i hapësirave të pronës së qytetarëve është rritur, nuk është zvogëluar.

Edhe nga të hyrat nga Parkingu dhe Hortikultura në vitin 2015 i kemi planifikuar 1 milion euro, i kemi realizuar 290 mijë euro, në vitin 2016 kemi planifikuar 2.5 milionë euro, kemi realizuar 407 mijë euro, megjithëkëtë në vitin 2017 prapë i planifikojmë 3 milionë euro.

Një tjetër dështim që bie komplet në kundërshtim me parimet e kryetarit dhe parimet të cilat i ka proklamuar në këto tri vitet e fundit, janë edhe vijat buxhetore në tendencën gjëja për kursimin e shpenzimeve të luksit, ndërsa në çdo vit shifrat kanë treguar të kundërtën.

**Lirak Çelaj**, kërkoi të dijë se këto investimet e tjera, shpenzimet kontraktuese, që është njëra në Drejtorinë e Administratës, këtu thotë prej 180.000 € të planifikuara, janë shpenzuar 732.942 €, kisha dashur të dijë se ku janë shpenzuar, se është një tejkalim shumë i madh, e njëjta vlen edhe për Drejtorinë e Arsimit.

Sa i përket veshmbathjes, më intereson të dijë se a janë blerë për administratën apo ndonjë institucion tjetër. Ndërsa në sigurimin e objekteve, pse janë rritur shpenzimet, çka ka ndodhur, a është rritur numri i objekteve, ku kanë shkuar, ne nuk po kemi informata për këto?!

**Agim Gashi** theksoi se në raportin e Kryetarit do të ishte dashur të përfshihej edhe një pasqyrë për bashkëpunimin me ndërmarrjet komunale. Ndërmarrjet komunale janë pronë e Komunës së Prishtinës dhe asnjë fjali mos të figuroj për to në raportin buxhetor njëvjeçar të kryetarit, më duket se nuk është në rregull. Ndërsa gjatë vitit 2016, nuk ka pasur fare rishikim të buxhetit dhe nuk e di se si kanë arritur me i ridestinuuar mjetet prej një projekti në një projekt pa rishikim të buxhetit.

Desha të pyes edhe diçka tek projekti rrethrotullimi Arbëri – Lakërishte, këtu figuron, unë së paku nuk e kam të qartë si kanë mbërri të shpenzohen ato mjete, kur nuk e di se ku është ai rrethrotullim Arbëri – Lakërishte. Asnjë institucion shkollor në Prishtinë nuk është ndërtuar, edhe pse nevojat janë shumë të mëdha, dhe së paku gjatë një viti kalendarik ne nuk kemi arritur të sigurojmë një lokacion të nevojshëm për ndërtimin e një objekti shkollor në lagjet që të gjithë e dimë, dhe në lagjet ku edhe më herët me dokumentet planifikuese është planifikuar dhe lokacionet janë të destinuara për ndërtimin e objekteve shkollore. Së paku faza përgatitore ka qenë dashur të kryhet për një objekt të tillë, i cili nuk është i vlerave të vogla dhe për të cilin duhet bukur kohë që të bëhen përgatitjet.

**Visar Arifaj** shprehu shqetësim se pse vetëm 147 mijë € investime kapitale gjatë tërë vitit në Drejtorinë e Kulturës, ku janë problemet, edhe pse nuk ka më shumë projekte në të cilat mund të investohet në kulturë.

**Shefki Gashi** pyeti se si është e mundshme, me këto kuadro kaq të kualifikuara në bazë të letrave, me ardhur deri tek ky skandal i planifikimit të dobët, i inkasimit të dobët, i shpenzimit të dobët marramendës.

**Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, u shpreh se këtu është një keqkuptim apo keqinterpretim i shpenzimeve të lëndëve djegëse për automjetet e Komunës së Prishtinës.

Sa për informim, po ju njoftoj se janë 58 automjete të cilat shfrytëzohen në bazë të raportit të shefit të autoparkut, si dhe në bazë të raportit të faturave të pranuar nga operatori ekonomik që i furnizon këto automjete, gjatë vitit 2016 janë shpenzuar gjithsejtë 55.198,89 € për 58 automjetet, jo për kodin buxhetor për të cilin u deklarua z. Flamur pak më parë, do të thotë 55.198,89 € për 58 automjetet Në bazë të shpenzimeve të vitit 2016, mesatarja e shpenzimit për një automjet del që është 9.6 litra krahasuar me vitin 2015, kur ka qenë 10.6 litra, d.m.th. këto janë të vërteta të sakta për shpenzimet e 58 automjeteve të autoparkut të Komunës së Prishtinës.

Në fund të vitit 2015, i kemi kyçur 1800 shërbyes të institucioneve shëndetësore, kryetarë të bashkësive lokale dhe të gjithë të tjerët të cilët nuk kanë qenë të kyçur.

Komuna e Prishtinës i ka 1860 shfrytëzues të telefonisë mobile.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, kërkoi nga të gjithë këshilltarët e Kuvendit të cilët kanë për të shtruar pyetje, nëse nuk marrin përgjigje sot, do të marrin me shkrim gjatë ditëve në vijim, me shpjegime konkrete për çdo pikë që kërkojnë.

**Shemsi Veseli**, lidhur me raportin e lëndëve që janë në procedurë të tenderimit, tha se kur do të kryhet ekzekutimi i tyre, mandej raportin e lëndëve që janë në ekzekutim dhe planin se kur do të kryhet ekzekutimi i tyre, si dhe raportin e lëndëve të cilat janë në fazën e përgatitjes për shpalljen e tenderit dhe planin se kur do të kryhet ekzekutimi i tyre, për arsye se po lidhet me 2017 dhe 2016. Gjithmonë kur kam diskutuar për buxhetin, kam kërkuar që të zërthehen nënkodet, kodet dhe t'i kemi sqarimet.

**Besart Vllahinja** theksoi se dy çështje që sot u ngritën, janë ngritur edhe në mbledhjen e KPF-së. Unë do ta trajtoj çështjen e subvencioneve. Subvencionet në Drejtorinë e Kulturës për vitin 2016 i keni publike në ueb-faqen e Komunës, emrin e përfituesit, emrin e projektit dhe mjetet me të cilat ata janë përkrahur, të gjitha janë publike, këto janë publikuar në emër të transparencës. Informatat tjera të cilat mund t'i kërkonit eventualisht, ju kisha sugjeruar me e shfrytëzuar Ligjin për qasje në dokumente publike dhe i keni informatat plotësuese.

**Agim Gashi** kërkoi sqarime lidhur me ngecjen e punimeve në renovimin e Xhamisë së Gurit, që ka mbetur tash e tri vjet pa u përfunduar.

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, lidhur me çështjen e renovimit të Xhamisë së Gurit dha sqarime të nevojshme.

**Hatixhe Pupovci** theksoi se ky raport duhet të jetë i publikuar në ueb-faqen e Komunës dhe përveç raportit si i tillë, secilit kod buxhetor dhe secilit vend ku ka qenë planifikimi dhe ku është realizimi, t'i vendoset një link me kontratat përkatëse.

**Kryesuesi** konstatoi se më 16 ( gjashtëmbëdhjetë) vota për, 20 (njëzet) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Egzona Podvorica, Fisnik Osmani, Flamur Shala, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shefqet Sylejmani, Shemsi Veseli dhe 1 (një) abstenim, (Vjollca Dibra - Ibrahimimi ), nuk u miratua Raportit vjetor buxhetor për vitin 2016.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017.**

**Visar Arifaj** ceku se në mbledhjen e fundit të mbajtur me grupin punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit 2017, të gjithë të pranishmit ishim dakord që të mos ndryshojë propozimplani në strukturën si është, përveç se të shtohet në fund të pikës së tretë një shpjegim, ku do të thuhej se dy mbledhjet e parapara për muajt janar edhe shkurt, duhet kompensuar në muajt në vijim.

**Kryesuesi** konstatoi se më 37 (tridhjetë e shtatë) vota për dhe 1 (një) abstenim (Halim Halimi), u miratua Plani i punës së Kuvendit për vitin 2017.

#### **Pika e shtatë**

**Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.**

**Kryetari, Shpend Ahmeti**, theksoi se kemi të bëjmë me realizimin e planeve rregulluese, këmbim të pronave me pronarë privatë, në njërin anë, një pronë e cila na ka lënë neve në pronësi për ndërtim, në fakt për administratë dhe për ndërtesa publike, ndërsa jepet parcela e Komunës që u mundëson pronarëve edhe ndërtime tjera për rrugë.

**Agim Gashi** tha se në KPF kanë qenë edhe dy lëndë të tjera, për të cilat ka insistuar shefi i Zyrës ligjore që të shtyhen. Unë kisha kërkuar, nëse ka mundësi, sqarime plotësuese dhe në njëfarë mënyre, njëfarë lloj garancie që nëse në këtë seancë nuk janë të gatshme lëndët, së paku të përgatitet për datën kur është paraparë seanca vijuese, në mënyrë që të mos bëjmë dallime në mes të palëve.

**Ardian Olluri** tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa, tek dy rastet të cilat janë tërhequr për këtë mbledhje, në fletën poseduese për pronën komunale, Zyra ligjore nuk

ka qenë e sigurt për çka është fjala, për çfarë shfrytëzuesi, dhe kemi kërkuar informacion nga Agjencia Kosovare e Privatizimit se a kemi të bëjmë me ndërmarrje shoqërore, apo është diçka tjetër.

Në momentin që materialet janë gati për këto dy rastet, mundën me u proceduar menjëherë.

**Shemsi Veseli** tha se do të ishte mirë që kur të merren këto vendime, edhe ashtu obligohet që brenda 15 ditëve deri në një muaj, që t'u jepen vendimet palëve, sepse ne po marrim vendim në Kuvendin e komunës.

**Ardian Olluri** dha sqarime të nevojshme lidhur me çështjen e ngritur nga z. Veseli.

**Rita Begolli** kërkoi nga kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit, që të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pronat rreth këmbimeve që janë gati, t'i dërgojnë në mbledhjen tjetër për votim, pasi që në gjashtë muajt e fundit të mandatit nuk mund të marrin vendime të tilla.

Është e rëndësishme që qytetarëve t'u bëjmë zgjidhje dhe mos të mbesin të bllokuar.

**Qëndron Kastrati** u shpreh se ne do t'i përkrahim propozimet e tanishme, por për neve si grup është e pamjaftueshme vetëm me material se si po shpjegohet çështja, edhe pse është interesi që tash të bëhet këmbimi i pronave.

**Muhamet Selmani** u shpreh në përkrahje të kësaj forme dhe inkurajoi kryetarin që sa më shumë që është nevoja të vazhdojë në këtë drejtim, sepse është mundësia më e mirë për kursimin e mjeteve të Komunës dhe zgjidhjen e shumë problemeve që i ka Komuna e Prishtinës. Ne e dimë se kemi shumë probleme me rrugë, të cilat nuk mund t'i zgjerojmë për shkak të këmbimit të pronave, sepse është shumë e kushtueshme.

**Hetem Kupina** shprehu mendimin se do të ishte mirë që të shtjellohen këto çështje, sepse, siç tha ai, unë e di mirë rastin që ka qenë pronë komunale e tash është kontestuese, dokumentet janë në Krushevc dhe nuk janë kthyer në Kosovë, andaj duhet pasur shumë kujdes.

**Abetare Fazliu** shprehu mendimin se edhe kjo çështje, ashtu sikurse edhe shumë çështje të tjera, duhet që sa më shpejt të zgjidhen dhe të mos bllokohen e të mos mbeten për fund, pastaj në mandatet e ardhshme të mbesin në gjysmë.

**Kryesuesi** konstatoi se më 32 ( tridhjetë e dy ) vota për, 2 (dy) vota kundër, ( Laura Zherka dhe Muhamet Nura) dhe 2 (dy) abstenime, (Genc Sherifi, Halim Halimi), konstatoi se u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.

## **Pika e tetë**

### **Qendra për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës.**

**Lirak Çelaj** u shpreh se ky kuvend ka shprehur qëndrimin që Qendrës për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës, t'i zgjatet afati ose t'i jepet mundësia për vazhdim të kontratës. Mendoj se nuk është trajtuar si duhet kjo Qendër, nuk është përfillur historia që ka kjo Qendër për veprat që i ka bërë, një Qendër e tillë e cila ka marrë përkrahje prej shumë donatorëve, kryesisht me donatorë ka mbijetuar, dhe ka pasur një mision human. Ne duhet ta përkrahim dhe t'ia mundësojmë ekzekutivi vazhdimin e kontratës kësaj organizate.

**Qëndron Kastrati** tha se për t'ia ndarë një hapësirë asaj organizate që udhëhiqet nga Flora Brovina, kërkesën duhet bërë nivelit qendror.

Ne si grup kemi thënë që e përkrahim këtë kërkesë nëse vjen, por nuk ka mundësi Komuna me e shmangur procedurën e konkurrencës, ose me ia vazhduar dikujt dhënien e pronës në shfrytëzim për një kohë të caktuar.

**Kryesuesi** theksoi se për këtë pikë nuk kemi material, andaj dhe e kemi titulluar si diskutim rreth kësaj çështjeje.

**Ardian Olluri** sqaroi se Kuvendi merr vendim për dhënien në shfrytëzim në bazë të vendimit të kryetarit. Për t'iu shmangur procedurave konkurruese duhet kërkesë nga niveli qendror. Kuvendi nuk mund të nxjerrë rekomandime pa u plotësuar kushtet.

**Ajnishahe Azemi** shprehu mendimin se, duke e pasur parasysh punën, kontributin dhe misionin që ka luajtur kjo qendër para, gjatë dhe pas luftës, meriton përkrahje që sa më shpejt të zgjidhet kjo çështje dhe t'i krijohet mundësia që të vazhdojë punën.

**Lirak Çelaj** ngriti shqetësimin e tij, duke thënë se cili parim është ndjekur atëherë kur janë dhënë çerdhet në shfrytëzim, të ashtuquajtura "me bazë komunitet", kur ato janë OJQ. Pse nuk është kërkuar mundësia e konkurrimit, siç po kërkohet edhe tash, pse nuk është ndjekur e njëjta procedurë ashtu siç po kërkohet në këtë rast?!

**Agim Gashi** shprehu mendimin se duhet kërkuar njëfarë lloj korrektesie nga të gjitha palët dhe të shkojmë ta votojmë në parim dhe në periudhën e ardhshme deri në seancën tjetër të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore, kërkesa nga niveli qendror, apo edhe çështje të tjera që mund të kërkohen nga Zyra ligjore.

**Shefki Gashi** tha se ajo organizatë e ka pasur në shfrytëzim atë pronë, të cilën ia kemi dhënë. Si Kuvend i Komunës, deri në një formim të një komisioni ose ndonjë situatë tjetër, mund t'ia vazhdojmë kontratën për një afat të pacaktuar deri në një vendim, kur në kuadër të ligjit ekzekutivi e bie një vendim tjetër dhe na e sugjeron neve që duhet me e marr këtu.

Përndryshe, nuk është në rregull pa vërejtje, pa asgjë me e larguar prej aty.

**Muhamet Selmani** apeloj që, nëse është e mundur, të ndajnë mjete për restaurimin e asaj Qendre, të mos mbetet vetëm në mëshirën e donatorëve, ende ka rolin e rehabilitimit, ende ushqehen aty njerëzit, këshillohen me psikologë të ndryshëm, ku të gjitha janë në baza vullnetare.

Nuk janë vetëm ushqime, janë veshmbathje, është fleta doganore kur mallrat kanë hyrë në Kosovë, më 20.12.2016, janë realisht 19.196,93 kilogramë, një kontejner që është i ngarkuar aty, ka ushqime të konservuara, ka veshmbathje, ka shtretër, ka dyshek, ka batanije, ka veshmbathje të tjera, këpucë e gjëra të tjera.

**Sali Zyba**, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se do ta verifikojmë secilën listë të evidencës që e ka bërë Drejtoria e Pronës, ku mua më është dëshmuar me një faturë, me një evidencë se çka kanë bartur prej aty, d.m.th. nëse e ke atë faturë ose atë dëshmi që janë 19 tonelata ushqime aty, për mua është shqetësuese.

**Arbërie Nagavci**, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, theksoi se çerdhet me bazë në komunitet nuk ua kanë dhënë në shfrytëzim OJQ-ve, por Komuna i ka renovuar të gjitha objektet ekzistuese. Ka pasur debat publik, ku janë ftuar të gjithë prindërit banorë të komunitetit, të cilët kanë fëmijë për regjistrim në çerdhe, që të marrin pjesë në debat publik. Banorët e asaj lagjeje apo atij komuniteti i kanë zgjedhur përfaqësuesit e tyre, të cilët e kanë themeluar Bordin e prindërve, dhe më pas vazhdojnë me procedurat për funksionalizimin e çerdheve.

Kushti ka qenë që të jenë banorë të lagjes dhe që të kenë fëmijë të asaj moshe, d.m.th. nuk është se objektet u janë dhënë në shfrytëzim organizatave të ndryshme joqeveritare pa ndonjë konkurrencë apo pa bazë ligjore.

**Flamur Shala** ceku se nuk është mirë ta bëjmë krahasimin në mes çerdheve me bazë në komunitet dhe në këtë rast të çerdhes së mundshme të një OJQ-je. Realisht, kemi nevojë për çerdhe, duke i pasur parasysh edhe kushtet që duhet të zhvillohen për procedimin.

**Kryesuesi konstatoi se më 30 ( tridhjetë ) vota për, 1 (një) votë kundër ( Vjollca Dibra - Ibrahimimi) dhe 2 (dy) abstenime (Hatixhe Latifi - Pupovci dhe Kimet Zeqa), në parim përkrahet Qendra për rehabilitimin e nënës dhe fëmijës.**

**Pika e nëntë**

**Caktimi i një anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA Prishtinë dhe në KRM "Pastrimi".**

**Agim Gashi, shef i GP të LDK-së**, tha se grupet parlamentare duhet t'i propozojnë kandidatët të cilët mendojnë se janë adekuat për këtë pozitë.

Faqe 16 nga 17



**Qëndron Kastrati** propozoi që paraprakisht të bëhet një takim me shefat e grupeve parlamentare nëse arrijmë pajtim për këtë pikë, nëse jo, atëherë vazhdojmë me propozimin e kandidatëve.

**Lirak Çelaj** theksoi se për këtë pikë jemi diametralisht kundër, por ta kalojmë proceduralisht.

**Kryesuesi** ceku se ndërmarrjet janë pa aksionarë tash e sa muaj.

Kjo mënyrë e daljes jashtë të anëtarëve të Kuvendit është e papranueshme, kjo tregon se ndërmarrjet po bllokohen për shkak të mos interesimit të disa subjekteve politike.

Konstatohet se tash jemi vetëm 23 anëtarë dhe nuk kemi kuorum.

**Flamur Shala** shprehu mendimin se vazhdimi i sjelljeve politike, edhe administrative, relacioneve me Kuvendin nga ana e ekzekutivit të Komunës së Prishtinës, drejtpërdrejt nga kryetari, Shpend Ahmeti, i cili tash e dy-tri vjet i ka bllokuar ndërmarrjet publike dhe ato nuk kanë funksionuar në mënyrën më normale në qeverisje për t'i kryer shërbimet e veta.

**Agim Gashi** tha se në raportin e punës nuk figuron asnjë fjalë për ndërmarrjet komunale. Kjo gjë është pritur dhe ajo po rezulton. Ekzekutivi po vepron dhe nuk është i interesuar që t'i normalizojë raportet me ne dhe me ndërmarrjet komunale.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:43.**

Procesmbajtësja  
Luljeta Selimi